



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 63 Prot.

Tiranë, më 23/01/2017

Lënda : Dërgohen rekomandime për Projektligjin “Disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të të Paraburgosurve”, të ndryshuar.

Drejtuar : **Z. Fatmir XHAFAJ**
Kryetari i Komisionit
Komisioni Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
KUVENDI I SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar i Komisionit!

Në vijim të ftesës së Komisionit Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtron sa më poshtë disa rekomandime në lidhje me projektligjin “Disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të të Paraburgosurve”, të ndryshuar.

Pasi u njohëm me përmbajtjen e projektligjit “Disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të të Paraburgosurve”, të ndryshuar, mendojmë se duhet të shtohet dhe një ndryshim i cili nuk është i parashikuar në projektligj, konkretisht **neni 43** i Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgim”, ku parashikohen subjektet të cilat mund vizitojnë institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale pa autorizim, propozojmë të përfshihet edhe institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si me poshtë:

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale mund të vizitohen pa autorizim nga: Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Zëvendëskryetari



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

*i Kuvendit, Zëvendëskryeministri, Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, deputetët, Zëvendësministri i Drejtësisë, Avokati i Popullit, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe zëvendësit e tij, Drejtori i Policisë së Burgjeve, drejtori dhe inspektorët e kontrollit të brendshëm të burgjeve, anëtarët e komisionit mbikëqyrës të ekzekutimit të vendimeve penale, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, gjyqtarët dhe prokurorët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si dhe avokatët e të burgosurve dhe të paraburgosurve. Nuk është i nevojshëm autorizimi për ata që shoqërojnë personat e përmendur në paragrafin e mësipërm, por gjithmonë jo më shumë se dy. Personat e tjerë, që nuk parashikohen në paragrafin e parë, mund të hyjnë në institucion vetëm me autorizim të drejtorit të institucionit. Këta persona, në rast refuzimi pa shkaqe të arsyeshme të dhënies së autorizimit nga drejtori i institucionit, kanë të drejtë të ankohen te Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve. Për përfaqësuesit e komuniteteve fetare zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 42 të këtij ligji.*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al